



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 48**

Datë: 11. 09. 2024 ora: 13:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Ilir Gashi, Arianit Elshani, Alban Krasniqi, Sami Hamiti, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Fazli Stollaj, Qemailj Kurtis, Mufera Shinik.

Burim Ahmetaj, krye shef i SKQZ. Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së
2. Procesverbali i mbledhjes së KQZ nr.47/2024
3. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ
4. Raport i Këshillave të KQZ

### **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të punëtorisë për mësimet e nxëna për projektin “Simulimi i procesit zgjedhor”;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave për fletëvotime dhe lista votuese për Zgjedhjet 2025;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave për të verbër për Zgjedhjet 2025;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për transportin e materialit zgjedhor;

## 5. Emërimet e Komisioneve Komunal e të Zgjedhjeve

### **Këshilli për Personel**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Sekretariatit për të lidhur marrëveshje me palët e treta,
  2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Sekretariatit të KQZ për angazhimin e personelit të përkohshëm për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2025 - Grupi i dytë.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i shenjave unike të KQZ-së.

---

### **1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

Kryetari Radoniqi, pasqyroj në këtë takim agjendën dhe i pyeti anëtarët, nëse kanë ndonjë propozim, vërejtje etj.

Arianit Elshani, tha se pikat nga KOZ – i (1, 3, dhe pika e 5) të tërhiqen sepse, ende nuk janë gati për miratim. Po ashtu, edhe Alban Krasniqi, tha se te Këshilli për Personal, pika e 3 të tërhiqet nga rendi i ditës sepse, edhe pak ka nevojë të shqyrtohet. Ndërsa, z. Elshani, propozoi që të shtohet pika: “Shqyrtimi dhe miratimi i listës së Qendrave Komunale të Numërimit”.

Pas këtyre propozimeve, anëtarët e KQZ-së me 10 vota për, miratuan rendin e ditës. Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së miratuan procesverbalet nga mbledhjet e KQZ nr.47/2024.

### **2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ:**

Burim Ahmetaj, the as në kuadër të planeve dhe operacionalizimit të tyre për zgjedhjet, më 29.08.2024 ka filluar periudha e kundërshtimit dhe konfirmimit të LV-së, mirëpo Sekretariati nuk ka pranuar kërkesë për kundërshtim të LV. Ndërsa, periudha e Regjistrimit të Votuesve jashtë Kosovës ka filluar me datë 29.08.2024 dhe do të përfundojë me datë 26.12.2024. ( Shtetasit të cilët jetojnë jashtë Kosovës kanë mundësi të regjistrohen përmes platformës elektronike dhe përmes postës. ) Deri më tani, shërbimi votues ka pranuar 2560 kërkesa për regjistrim, të cilat edhe janë

shqyrtuar. Të aprovuara janë 2310 kërkesa ndërsa të refuzuara 250 kërkesa. ( Përmes postës janë pranuar 3 aplikacione të cilat nuk janë procesuar, për arsye se janë dërguar fizikisht nga aplikuesit në postën e Kosovës, pra vula dhe pulla postare kanë qenë të Kosovës, jo të shtetit ku jetojnë. )

Në vazhdim të raportit të tij, z. Ahmetaj tha se zbatimi i periudhës për Ndërrimin e Qendrës së Votimit ka filluar me datën 29.08.2024 dhe do të përfundojë me datën 26.12.2024. Deri me datën 11.09.2024, janë pranuar 252 kërkesa për ndërrimin e qendrës së votimit. Nga këto, 239 kërkesa janë aprovuar dhe, 13 kërkesa janë refuzuar.

Ndër aktivitetet e tjera, z. Ahmetaj ka theksuar aktivitetin e planit të punës së KQZ për takimet me Kryetarët e Komunave dhe me Kryesuesit e Kuvendeve Komunale gjë që, kjo është arritur gjatë muajit qershor dhe korrik. Në kontekst, z. Ahmetaj tha se komunat me ligjin për zgjedhjet e përgjithshme, janë të obliguara që t'i ofrojnë mbështetjen e nevojshme KKZ-ve në kuptimin e sigurimit të hapësirave për punë, depo për materiale, transport, objektet publike për nevoja të votimit apo ambiente tjera për organizimin e trajnimeve të komisionarëve dhe numëruesve, si dhe hapësira për adaptimin e qendrave komunale të numërimit. Deri më tani, janë nënshkruar 17 memorandume të bashkëpunimit mes KQZ dhe Komunave,

Në lidhje me zyrat e KKZ-ve në secilën komunë, Sekretariati është duke marrë veprime për shfrytëzimin e rrjetit qeveritar në të gjitha zyret e KKZ-ve si dhe duke evidentuar gjithë materialet në Depo të KKZ-ve dhe tërheqjen e tyre, tha në fund të raportit z. Ahmetaj.

Alban Krasniqi tha se, shërbimi votues e ka nda edhe një numër telefoni pa pagesë që, bashkëvendësit të marrin informacione. Ky numër, sa më parë të bëhet publik, dhe të shpërndahet sa më shumë. Përtej imelave dhe telefonat – numrat e tjerë, do jetë edhe një tjetër, dhe të informohen qytetarët. Po ashtu, mund ta kemi edhe një “tabelë” rreth aplikimeve, aprovimeve, refuzimeve etj.

### **3. Raport i Këshillave të KQZ:**

#### **1. Këshilli për Operacione Zgjedhore**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave për fletëvotime dhe lista votuese për Zgjedhjet 2025:

**Arianit Elshani**, tha se këshilli i ka shqyrtuar detajisht këto specifike, përmbajtjet, prandaj sasia e gjithë materialit përfshinë: fletëvotimet e zgjedhjeve parlamentare 2024, fletëvotimet që do përdoren për kryetar komune në zgjedhjet lokale 2005, dhe fletëvotimet që do përdoren për zgjedhjet për kuvendet komunale 2025. Po ashtu, hyjnë edhe broshurat për zgjedhjet...

Për zgjedhjet për Kuvend, sasia e përafërt e fletëvotimeve është: 1, 900, 000 copë. Broshurat: 16, 000.

Fletëvotimet për Kuvendet Komunale: 1, 900, 000. Broshura: 16, 000.

Fletëvotimet për Kryetar Komune: 1, 900, 000. Për raundin e dytë: 1, 250, 000 fletëvotime. Dhe, 6,850 lista votuese, dhe 1,10 lista votuese për votues me kusht. Pra, është një kontratë të gjitha proceset zgjedhore të planifikuara me ligj. Rekomandojmë për miratim...

Me 10 vota për, u miratuan specifikat te fletëvotime dhe lista votuese për Zgjedhjet 2025.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për transportin e materialit zgjedhor:

**Arianit Elshani**, referoi edhe në këtë pikë dhe tha se KOZ ka shqyrtuar specifikat teknike të materialit sensitiv dhe jo sensitiv, por edhe transportin e materialit zgjedhor. Gjatë proceseve, kemi nevoja të ndryshme, këtu përfshihen të gjitha transportet dhe ne konsiderojmë që operatorët që e kanë si fushëveprim këtë aktivitet të kihen parasysh. Ne, rekomandojmë që kjo pikë të miratohet.

Anëtarët e KQZ me 10 vota për, miratuan edhe këtë rekomandim të KOZ-it.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i listës së Qendrave Komunale të Numërimit”:

**Arianit Elshani**, tha se e kemi shqyrtuar këtë pikë, dhe ky është aktivitet që ndërmerret për herë të parë nga KQZ që pas ndryshimit të ligjit për zgjedhje. QKN-të, do të shërbejnë si vend për

grumbullimin e materialit para ditës së zgjedhjeve, dhe pastaj edhe për numërimin e votave Votat e kandidatëve, nuk do të numërohen më në VFV, por në QKN dhe ne, kemi përcaktuar kriteret e duhura dhe gjithçka tjetër që lidhet, si hapësira, infrastruktura. Kjo listë në 38 komuna, përbëhet nga sallat e sportit, dhe aty-këtu ndonjë shtëpi kulture që ka hapësirë etj. Ne, e kemi shqyrtuar mirë problemin, dhe të mos harrojmë se kemi morandume me komunat dhe presim përkrahje, kështu që ne rekomandojmë për miratim...

Me 10 vota për, miratohen Qendrat Komunale të Numërimit në 38 komuna.

## **2. Këshilli për Personel**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Sekretariatit për të lidhur marrëveshje me palët e treta:

**Alban Krasniqi**, tha se Këshilli për Personel ka shqyrtuar kërkesën e Sekretariatit për të lidhur marrëveshje me palët e treta, me institucionet tjera apo të themi, transferit të stafit të përkohshëm me qëllim të kryerjes së detyrave meqë disa pozita i kemi të lira. Janë disa të sferave financiare, dhe kemi nevojë për staf të përkohshëm, për shembull të zyrtarit financiarë. Është rasti me PZAP-në, që të ketë një marrëveshje të këtillë me një zyrtar për afat të caktuar, deri sa ta kemi të plotësuar pozitën e rekrutimit...

Me 10 vota , për u miratua kjo kërkesë e Sekretariatit.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Sekretariatit të KQZ për angazhimin e personelit të përkohshëm për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2025 - Grupi i dytë:

**Alban Krasniqi**, referoi edhe në këtë kërkesë. Ai tha se, në bazë të kërkesave nga njësitë përkatëse, pas shqyrtimit në personel për grupin e dytë, janë gjithsej: 13 pozita. Pozitat, kanë përshkrimet, dhe ne rekomandojmë për miratim...

Me 10 vota për, u miratua kërkesa e Sekretariatit të KQZ për angazhimin e personelit të përkohshëm për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2025 - Grupi i dytë.

## **4. Të ndryshme!**